



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:218826

Datë: 19.03.2024

Numri i dokumentit: 05474806

CP.nr.1059/2021

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-Departamenti i Përgjithshëm me gjyqtarin Genc Hasani dhe me bashkëpunëtoren profesionale Valbona Tahiri, në lëndën përmbartimore të kreditorëve A. L., L.M., B. B., M. P., V. P., S. P., S. Sh., L. K., Sh. P., V.U., të cilët me autorizim i përfaqëson avokat Leutrim Ademi me seli në Mitrovicë, ndaj debitorit Komuna e Mitrovicës, - Drejtoria e Arsimit, lidhur me pagesën e borxhit në bazë të dokumentit përmbartimor - Aktgjykimi Cnr. 591/2019, të datës 25.06.2021, të lejuar me aktvendimin për përmbartim CP.1059/2021, të datës 09.09.2021, jashtë seance gjyqësore, me datën 19.03.2024 morri këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDOHET procedura përmbartimore e udhëhequr sipas shenjës CP.1059/2021, me kreditor A. L., L.M., B. B., M. P., V. P., S. P., S. Sh., L. K., Sh. P., V.U., ndaj debitorit Komuna e Mitrovicës, -Drejtoria e Arsimit,” për shkak të pagesës së tërësishme të borxhit nga debitori.

A r s y e t i m

Kreditorët e përmbartimit A. L., L.M., B. B., M. P., V. P., S. P., S. Sh., L. K., Sh. P., V.U., përmes të autorizuarit të tyre avokat Leutrim Ademi me seli në Mitrovicë, kanë paraqitur propozim për përmbartim në bazë të dokumentit përmbartimor - Aktgjykimi Cnr 591/19, të datës 25.06.2021.

Gjykata Themelore në Mitrovicë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit të përmbarimit, me aktvendimin CP.1059/2021, te datës 09.09.2021, ka lejuar përmbarimin ndaj debitorit Komuna e Mitrovicës - Drejtoria e Arsimit”.

Pasi aktvendimi për ekzekutim CP.1059/2021, te datës 09.09.2021, është bere i ekzekutueshëm, kreditori nëpërmes përfaqësuesit me autorizim me dt. ..., ka njoftuar gjykatën se debitori i përmbarimit e ka përmbushur në tërësi borxhin.

Andaj, borxhi i kërkuar sipas propozimit për përmbarim është përmbushur në tërësi, pasi që debitori ka përmbushur në tërësi obligimin ndaj kreditorit të përmbarimit, gjykata duke u bazuar në nenin 66 paragrafi 4 të LPP-së, në të cilin parashihet se *“Pas përmbushjes se kredisë se kreditorit nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përmbarimore”*, vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti i Përgjithshëm

CP.nr.1059/2021 më datë 19.03.2024

Gjyqtari

Genc Hasani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa brenda afatit 7 ditorë nga dita e pranimit te të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Mitrovicë.